

D E K R E T
Nr.7448, datë 5.1.1991

**PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT NETO, QË KOOPERATIVAT BUJQËSORE
DERDHIN NË BUXHETIN E SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Kooperativat bujqësore derdhen në buxhetin e shtetit një pjesë të së ardhurës neto, që krijojnë nga veprimtaria e tyre ekonomike.

Neni 2

Tarifat e derdhjes së buxhet të tatimit mbi të ardhurat neto nga kooperativat bujqësore të jenë 3, 5, 7, 9, 11 dhe 13 për qind, në varësi nga madhësia e fondit për rishpërndarje për krahë pune.

Neni 3

Tatimi mbi të ardhurat neto, që kooperativat bujqësore derdhen në buxhet, llogaritet nga vetë kooperativat, sipas kriterëve që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Mënyra e llogaritjes dhe e derdhjes në buxhet të tatimit mbi të ardhurat neto caktohet nga Ministria e Financave.

Neni 4

Organet financiare ushtrojnë kontroll për saktësinë e llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat neto që derdhen në buxhet. Afatet e derdhjes në buxhet dhe kështu e tatimit parashikohen në planin financiar të kooperativës bujqësore.

Neni 5

Në rast se tatimi mbi të ardhurat neto nuk derdhet në buxhet në afatet e parashikuara, shumat e paderdhura nxirren nga llogaria likuiduese e kooperativave bujqësore me urdhër të përgjegjësit të seksionit të financës të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të rajonit. Për çdo ditë vonësë në derdhjen e tatimit vendoset kamatvonesë, në masën 0,05 për qind mbi shumën e detyrimit.

Neni 6

Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, në raste të veçanta,

mund të bëjnë përjashtime nga derdhja në buxhet e tatimit mbi të ardhurat neto.

Neni 7

Ligji nr.5842, datë 20.2.1979 "Për të ardhurën neto të centralizuar nga kooperativat bujqësore", shfuqizohet.

Neni 8

Ky dekret hyn në fuqi më 1.1.1991.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETAR
Sihat Tozaj

KRYETAR
Ramiz Alia